


VËSHTIRËSIA TË REJA për “vendastit” në KOMPETENCAT LOKALE

Ndjekja e procesit të decentralizimit
për veprimtaritë komunale në RM
Raporti 2011



VËSHTIRËSIA TË REJA për “vendaset” në KOMPETENCAT LOKALE

Ndjekja e procesit të decentralizimit
për veprimtaritë komunale në RM
Raporti 2011

Shkup, mars 2012

Boton:

Fondacioni Shoqëri e hapur – Maqedoni

Për botuesin:

Vlladimir Millçin, Drejtor ekzekutiv

Përgatiti:

Georgi Hristov, Jane Vrteski, Natasha Ilijeva – Acevska
Qendra për zhvillimin e demokracisë lokale

Redaktorë:

Fani Karanfillova - Panovska
Kire Milovski
Aleksandar Stojanovski

Përktimi:

Abakus

Formësimi artistik - grafik:

Koma

Shtyp:

Propoint

Tirazhi:

100

Tirazh pa pagesë/jo komercial

CIP - Каталогизација во публикација
Национална и универзитетска библиотека "Св. Климент Охридски", Скопје

342.25(497.7)"2011"(047.31)

ХРИСТОВ, Георги

Нови тешкотии за "староседелецот" во локалните надлежности : следење на процесот на децентрализација во комуналните дејности во РМ : извештај 2011 / [Автори Георги Христов, Јане Врtesки, Наташа Илијова-Ацевска]. - Скопје : Фондација отворено општество - Македонија, 2012. - 47, 44 стр. : табели ; 24 см

Насл. стр. на припечатениот текст: Vështirësia të reja për "vendaset" në kompetencat lokale : ndjekja e procesit të decentralizimit për veprimtaritë komunale në RM : raporti 2011. - Обата текста меѓусебно печатени во спротивни насоки. - Текст на мак. и алб. јазик. - Фусноти кон текстот. - Содржи и: Анекс 1-4

ISBN 978-608-218-144-8

1. Врtesки, Јане [автор] 2. Илијова-Ацевска, Наташа [автор]

а) Децентрализација - Македонија - 2011 - Извештаи
COBISS.MK-ID 91686154

Ky raport është përgatitur në kuadër të projektit "Decentralizim transparent dhe efikas", të cilin e zbaton Fondacioni Shoqëri e Hapur - Maqedoni (FSHHM) në bashkëpunim me Qendrën për Zhvillim të Demokracisë Lokale (QZHDL)

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE	5
ZBULIME KYÇE	9
1. Veprimtaritë komunale në Republikën e Maqedonisë	12
1.1 Kompetenca të komunave në veprimtarinë komunale	12
1.1.1 Kompetenca të komunave	12
1.1.2 Ndërmarrje Publike Komunale (NPK)	13
1.2 Shtrirja institucionale	15
1.3 Korniza ligjore	18
1.3.1 Ujësjiellje dhe kanalizim	19
1.3.2 Mbeturinat komunale	23
1.4 Perceptimi i qytetarëve për shërbimet komunale	26
2. Analiza e rezultateve nga monitorimi i veprimtarive komunale në RM për vitin 2011	29
2.1 Indeksi i veprimtarive komunale	29
2.2 Nën-indeks për zbatimin e politikave	31
2.3 Nën-indeksi i gjendjes financiare i komunave për ZEL	33
2.4 Nën-indeks për performancat e shërbimeve komunale në ZEL	36
2.5 Nën-indeks për transparencë dhe përgjegjshmëri në ZEL	40
3. Rekomandime	43



Parathënie

Ky raport është raporti i katërt tremujor që është hartuar në kuadër të projektit “Decentralizim transparent dhe efikas”, të cilin e zbaton Fondacioni Shoqëri e Hapur - Maqedoni (FSHHM) në bashkëpunim me Qendrën për Zhvillim të Demokracisë Lokale (QZHDL) në 12 partner komuna¹ gjatë periudhës 2011-2012. Qëllimi i projektit është të stimulojë proces efikas, transparent dhe të hapur të decentralizimit me anë të vëzhgimit, njoftimit dhe informimit publik për transferimin dhe zbatimin e kompetencave nga ana e komunave në fushat e: financave, arsimit, urbanizmit dhe planifikimit urbanistik, zhvillim lokal dhe rajonal si dhe veprimtari komunale. Në kuadër të projektit, gjithashtu është bërë edhe hulumtim në teren me qëllim të matjes së kënaqësisë së qytetarëve për shërbimet që i marrin nga pushtetet lokale dhe të bëhet një analizë krahasuese të kënaqësisë nga shërbimet që i marrin në nivelin lokal mes vitit 2010 dhe 2011 si dhe transparenca dhe përgjegjshmëria e komunës për dhënien e shërbimeve.

Në këtë raport janë përmbledhur rezultatet e vëzhgimit të zbatimit të decentralizimit gjatë vitit 2011, duke analizuar sektori komunal në dhjetë prej partner komunave². Përveç konkluzioneve nga hulumtimi, raporti përfshin edhe një pasqyrë të decentralizimit nga aspekti i veprimtarive komunale. Të gjitha të dhënat dhe analizat e prezantuar në këtë raport kanë të bëjnë me vlera mesatare/nota që kanë arritur partner komunat në fushën komunale, ndërsa të dhëna për arritjet individuale të secilës komunë dhe analizë të hollësishme të secilit indikator posedojnë vetëm partner-komunat përkatëse.

Për të siguruar vazhdimësi dhe unifikim të rezultateve me raportet paraprake për financat, arsimin, urbanizmin, zhvillimin ekonomik lokal (ZEL), njësoj ky hulumtim ka përdorur qasjen e njëjtë metodologjike dhe metodologjinë specifike që është

1 Bogovinë, Veles, Gostivar, Dibër, Ilinden, Karposh, Kumanovë, Negotinë, Ohër, Staro Nagoriçanë, Strumicë dhe Tetovë

2 Komuna e Karposhit nuk ushte e përfshirë në analizën për shkak të kompetencave të ndara në fushën komunale me qytetin e Shkupit ndërsa komuna e Tetovës nuk i ka siguruar me kohë të dhënat e duhura.


përdorur gjatë hulumtimeve paraprake³ në fushat financa, arsim, urbanizëm dhe ZEL, gjegjësisht:

- janë matur 15 indikatorë të rinj nga fusha komunale, që mund të bashkohen me 60 indikatorët paraprak nga fushat e financave, arsimit, urbanizmit dhe ZEL, që paraqesin një bashkim të treguesve kritik për performancat në nivelin lokal ndërsa një pjesë e tyre inkorporojnë edhe ndikimet nga niveli qendror i pushtetit;
- është zbatuar qasje holistike që i merr parasysh: 1) politikat kombëtare në fushën komunale; 2) pavarësinë fiskale dhe kapacitetin e komunës për zbatim të kompetencës; 3) performancat e komunës gjatë dhënies së shërbimeve të caktuara, dhe 4) shkalla e transparencës dhe përgjegjshmërisë së komunës gjatë zbatimit të kompetencës.

Qasja e tillë metodologjike parashikon kalkulim të një indeksi të ri të performancave të decentralizimit (IPD) në fushën e veprimeve komunale, ndërsa për kalkulimin e saj sërish përdoret metodologjia e dizajnuar paraprakisht⁴, sipas të cilës indeksi fitohet nga katër nën-indekse përkatëse, që kalkuloohen nëpërmjet shumë indikatorëve për secilin nën-indeks në veçanti. Shkurtimeisht, caktimi i indeksit për veprimtaritë komunave e ndjek procesin që është dhënë më poshtë në figurën dhe duhet pasur parasysh që indeksi, nën-indeksi dhe indikatorët vlerësohen edhe njëherë sipas peshës, d.m.th. të gjithë ata nuk marrin pjesë me peshë të njëjtë (domethënie) në caktimin e indeksit të plotë të decentralizimit në sferën komunale. Vlera e secilit prej indikatorëve, nën-indekseve dhe indeksit lëviz prej 1 deri 5.

3 „Raporti për Ndjekjen e Procesit të Decentralizimit”, Fondacioni Shoqëri e Hapur – Maqedoni, shkurt 2010, i gatshëm në http://soros.org.mk/dokumenti/sledenje_decentralizacija_mk_web.pdf

4 Për informata më të hollësishme dhe qasjen metodologjike dhe metodologjinë e shfrytëzuar gjatë hulumtimit mund të konsultoni “Raporti për Vëzhgimin e Procesit të Decentralizimit: Performanca të komunave në RM 2008-2009”, FIOOM (2010) në gjuhën maqedonishte, shqipe dhe anglishte në ueb faqen <http://www.soros.org.mk/default.asp?lang=mk&menuid=430>




Sërish dëshirojmë të theksojmë që parimi kryesor gjatë këtij monitorimi është objektiviteti. Për të arritur nivelin maksimal të objektivitetit gjatë hulumtimit, ishin ndërmarrë hapat në vijim:

- ▶ Grumbullimi dhe sigurimi i të dhënave primare është bërë me anë të anketës të zbatuar në 11 partner komunat, me plotësimin e pyetësorëve nga nëpunësit përgjegjës shtetëror të gjitha fushave të hulumtuara;
- ▶ Vlerësimi i vlerës së indikatorëve bëhet me krahasimin e gjendjes së konstatuar dhe kritereve të përcaktuar sipas standardeve ligjore ose vlerave mesatare;
- ▶ Indekset dhe nën-indekset për secilën komunë dhe fishë kalkulohen me anë të formulave ekzakto matematike të cilat rezultojnë me notimin sasior për nivelin e performancave të komunave në fushat përkatëse;
- ▶ Ishin përdorur edhe burime plotësuese të të dhënave: rregullore ligjore, lajmëtar zyrtar të komunave, tregues statistikor dhe analiza etj.

Pas prezantimit të zbulimeve kyçe (kryesore) nga hulumtimi, jepet një pasqyrë e vogël e sferës komunale në Republikën e Maqedonisë, dhe pastaj janë prezantuar rezultatet e hollësishme me analiza në nivel të nën-indeksit dhe indikatorëve. Në fund në mënyrë laksative janë numëruar rekomandimet që mund të shërbejnë për

sjelljen e politikave përkatëse që të stimulohet dhe përmirësohet dhënia e shërbimeve komunale në RM. Rekomandohet që para leximit të raportit, të interesuarit të marrin parasysh “Raporti mbi Ndjekjen e Procesit të Decentralizimit: Performanca të komunave në RM 2008-2009”, FISHH (2010)⁵.



5 I gatshëm në gjuhën anglishte, maqedonishte dhe shqipe <http://www.soros.org.mk/default.asp?lang=mk&menuid=430>, http://soros.org.mk/dokumenti/sledenje_decentralizacija_eng_web.pdf

Zbulime kyçe

Konkluzioni i përgjithshëm që mund të nxirret është se komunat tregojnë rezultate të kënaqshme për organizimin dhe zbatimin e shërbimeve komunale por ju paraprin një sfidë e madhe për plotësimin e kërkesave të rrepta që dalin nga rregulloret e BE-së në sektorin, posaçërisht në pjesën e ujit dhe mbeturinave, i dhe komunat kanë nevojë për më tepër mjete financiare që të mund të mirëmbajnë dhe zhvillojnë sektorin komunal sipas standardeve të BE-së. Analizat sugjerojnë se investimet në sektorin komunal vlerësohen të jenë rreth 400 milion në ujëra të zeza⁶ dhe 400 milion tjera për mbeturina⁷, për zbatimin e plotë të direktivave të BE-së në sektorin.

Zbulimet tjera kyçëse janë:

- Ndikim më të madh mbi organizimin dhe zbatimin e veprimtarive komunale, njësoj sikur edhe me kompetencat tjera (përveç ZEL), ka gjendja financiare e komunës. Mirëpo, nga ana tjetër, indikatorët e matur financiar tregojnë rezultat më të dobët me notë mesatare prej 2.34 që tregon për gjendjen e keqe financiare në sektorin.
- Për të zbatuar me sukses politikat në veprimtarinë komunale (posaçërisht ata që janë përputhur me rregulloret e BE-së në sektorin, si për shembull, ujë dhe mbeturina) komunat kanë nevojë të menjëhershme të mjeteve financiare për të siguruar instrumente aktuale fiskale dhe mjete me të cilat punojnë. Madje 85% të komunave mendojnë se investimet në sektorin komunal duhet të mbështeten nga Qeveria.
- Politikat aktuale për borxhmarrje janë një faktor kufizues për investime më të mëdha infrastrukture ne nivelin lokal, ndërsa nga ana tjetër komunat kanë nevojë më të madhe të hyrjes në borxh për të realizuar investime kapitale në nivelin lokal. Më konkretisht, (1) komunat kanë nevojë për borxhmarrje për të realizuar investime infrastrukture në nivelin lokal, (2)ndikimi i pushtetit qendror është tepër i madh në kuptim të së drejtës për borxhmarrje të


6 Versioni i punës i Raportit Analitik mbi përparimin e zhvillimit dhe zbatimin e projekteve për investime në mjedis në EJJ, Banka Botërore 2008

7 Strategjia për Trajtimin e Ujërave të Zeza në Republikën e Maqedonisë 2008-2020, MMJPH 2008

komunave, (3) numri i madh i komunave (60% në rastin tonë) presin përgjigje (pozitiv ose negativ) nga Qeveria për borxhmarrje.

- Komunat mendojnë se politikat ekzistuese në sektorin komunal janë në nivelin e duhur dhe që pjesa më e madhe janë në përputhje me kërkesat e BE-së, por nga ana tjetër, janë të vetëdijshëm që zbatimi i tyre në nivelin lokal është e vështirë për shkak të mungesës së kapaciteteve lokale (institutionale, financiare dhe kuadro). Sipas rezultateve të fituara, komunat mendojnë se zbatimi i drejtë i Ligjit mbi Ujërat është sfida më e madhe, ndërsa janë më pak të kënaqur me nivelin e konsultimit gjatë sjelljes së politikave kombëtare (shtetërore) në pjesën e veprimtarive komunale.
- Gjendja financiare e komunave për veprimtaritë komunale është shumë kritike. Nëse merret parasysh fakti që shërbimet komunale shpesh jepen nga NPK, kjo bën me dije që edhe performanca e tyre financiare dhe nevoja është në nivel kritik. Përveç kësaj, plotësimi i direktivave të rrepta të BE-së në sektorin sigurisht që do të kërkojë investime më të mëdha kapitale të cilat komunat nuk do të mund të arrijnë. Për shembull, investimet e plota kapitale të gjitha komunave në gjitha sektorët gjatë vitit 2010 ka qenë rreth 70 milion euro që është 9% e investimeve të nevojshme kapitale për sektorët ujësjellje, kanalizim dhe mbeturina.
- Komunat shpeshherë i vlerësojnë me lartë buxhetet e programeve për veprimtari komunale dhe mesatarisht arrijnë të realizojnë vetëm gjysmën e planit. Gjithashtu, komunat tregojnë rezultate të dobëta në lidhje me planifikimin shumëvjeçar të investimeve kapitale për veprimtari komunale dhe vetëm 30% të komunave kanë hartuar plane për planifikim shumëvjeçar për investime kapitale dhe të cilat janë mbështetur me ndarje përkatëse buxhetore për realizimin e tyre.
- Në vitin 2010, vetëm 277 mkd/banor kanë qenë të synuar për investime kapitale në sferën komunale që paraqet rreth 15% të buxhetit të plotë për programe komunale. Më e keqe është situata në vitin 2011 kur janë realizuar vetëm 233 mkd/banor ose 12.5% të buxhetit për programe komunale. Më tutje, mbështetjen financiare që e marrin nga pushteti qendror për investime infrastrukturore në veprimtarinë komunale është vlerësuar si minimale ndonëse ai është një faktor i qëçantë.
- 80% të komunave të analizuar japin besimin për punën NPK-së. Duke marrë parasysh që investimet kapitale janë minimale, kjo informatë tregon që subvencionimi shpeshherë përdoret për mbulimin e shpenzimeve aktuale nga puna.
- Shërbimet komunale shpeshherë zbatohen nga Ndërmarrje Publike Komunale, por nuk është numri i vigël i shërbimeve komunale që zbatojnë vetë komunat. Zbatimi i shërbimeve komunale nga një partner privat është forma më pak e përfaqësuar.

- PAGESA për shërbimet e zbatuara perceptohet si një parakusht mjaft i rëndësishëm i komunave për të siguruar shërbime komunale. Në përgjithësi, ndërmarjet publike komunale janë më efektive kur bëhet fjalë pagesa për dallim nga kompanitë private ndërsa mesatarisht pagesa lëviz deri më 65%.
- Mbulim më të madh të zbatimit të shërbimeve komunale (ujësjellje dhe kanalizim, largim dhe deponim të mbeturinave, ndriçimi publik i rrugës, asfaltimi i rrugëve lokale dhe rrugëve) ka në pjesët urbane të komunave (qyteteve), ndërsa në pjesët rurale më pak janë të mbuluar me shërbimin.
- Nën-indeksi për transparencë dhe përgjegjshmëri ka vlerë më të madhe (4.13) në krahasim me nën-indeksat tjera, kryesisht për shkak të plotësimit të obligimeve formale për transparencë dhe përgjegjshmëri. Mirëpo, perceptimi i qytetarëve për punën transparente dhe të përgjegjshme të komunave është shumë më i vogël (2.68) që tregon se duhet të sigurohet transparencë dhe përgjegjshmëri thelbore dhe jo të jetë vetëm formale.
- Komunat marrin shumë pak kërkesa për lëshimin e informatave me karakter publik dhe në 86% të rasteve i janë përgjigjur brenda afatit ligjor. Kjo tregon për faktin që qytetarët janë shumë pak me instrumentet dhe mundësitë për qasje në informatat me karakter publik.



1. Veprimtaritë komunale në Republikën e Maqedonisë

1.1 Kompetenca të komunave në veprimtarinë komunale

Pas nënshkrimit të Marrëveshjes Kornizë të Ohrit (2001) dhe miratimit të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale (2002), Qeveria e Maqedonisë ka hartuar një program operativ për decentralizim, në të cilën kanë qenë të përfshirë përshtatjet e nevojshme në legjislaturën me të transferuar disa kompetenca prej nivelit qendror në atë lokal (arsimi, shëndeti, kultura, sporti). Megjithatë, shërbimet komunale në RM siç janë ujësjellje, kanalizimi, mbeturinat komunale, pastrimi publik, varrezat, etj., çdoherë kanë qenë kompetenca të vetëqeverisjes lokale madje edhe në kohën kur Republika e Maqedonisë ka qenë pjesë e ish Jugosllavisë dhe prandaj paraqesin një lloj “vendas” në mesin e kompetencave të komunave.

1.1.1 Kompetenca të komunave

Ligji për Vetëqeverisje Lokale (Gazeta Zyrtare, 5/2002) është ligj sistemor që i përcakton kompetencat e komunave. Me këtë ligj, “komuna” është përcaktuar si “njësi e vetëqeverisjes lokale, si bashkësi e banorëve në një rajon përkatës, e përcaktuar me ligji, që nëpërmjet organeve të saja dhe administratën dhe shërbimet publike të organizuar, mundëson kryerjen e kompetencave të përcaktuara me ligji. Nga ana tjetër, shërbimet publike janë përcaktuar si “organizata joprofitabile për kryerjen e shërbimeve publike (ndërmarrje publike dhe institucione publike), që kryejnë veprimtari të interesit publik me rëndësi lokale”. Në raste kur shërbimet publike realizojnë profit, atëherë atë tërësisht e përdorin për përmirësimin e shërbimeve dhe punës së shërbimeve publike për të ulur shpenzimet e shërbimeve dhe të përmirësohet cilësia e tyre. Me nenin 22 janë përcaktuar edhe kompetencat e njësisve të vetëqeverisjes lokale. Mes tjerash, me këtë nen janë përcaktuar edhe veprimtaritë komunale tjera, si: furnizimin me ujë të pijshëm; largimin e ujit teknologjik, përcaktimi dhe pastrimi i ujërave të zeza; ndriçimin publik; dërgimi dhe trajtimi i ujërave atmosferik; mirëmbajtja e pastërtisë publike, transporti dhe veprimi me mbeturinat e forta dhe teknologjike komunale; regullimi dhe

organizimi i transportit lokal publik i udhëtarëve, furnizimi me gaz natyror dhe energji ngrohjeje; mirëmbajtja varrezave, varrezat, krematoriumet dhe ofrimi i shërbimeve për varrim; ndërtimi, mirëmbajtja dhe rindërtimi dhe mbrojtja e rrugëve lokale, rrugëve dhe objekte tjera infrastrukture; rregullimi i regjimit të trafikut; ndërtimi dhe mirëmbajtja e sinjalizimit të trafikut rrugor; ndërtimi dhe mirëmbajtja e hapësirës publike për parkim; largimi i makinave që nuk janë parkuar mirë; largimi i makinave të vjetra nga sipërfaqet publike; ndërtimi dhe mirëmbajtja e tregjeve; pastrimi i oxhaqeve; mirëmbajtja dhe përdorimi i parqeve, jeshileve dhe park-pyjeve dhe sipërfaqeve për çlodhje; rregullim, mirëmbajtje dhe përdorim i shtretërve të lumenjve në pjesët urbanistike; caktimi i emrave të rrugëve, shesheve, urave dhe objekteve tjera infrastrukture.

Siç mund të vërehet, kompetencat e komunave në pjesën e veprimtarive komunale janë të shumta dhe llojllojshme, dhe njëherë këto kompetenca kanë ndikim të madh mbi jetën e përditshme të qytetarëve dhe komunës në tërësi. Për shkak të rëndësisë që kanë shërbimet komunale nga njëra anë, dhe kapacitetet kufizuese të administratave komunale, pothuaj të gjitha komunat në RM kanë formuar Ndërmarrje Publike Komunale (NPK) dhe ata kanë të drejtën të japin një ose më tepër shërbime të fushës komunale.

1.1.2 Ndërmarrje Publike Komunale (NPK)

Ndërmarrjet Publike Komunale (NPK) formohen për kryerjen e aktiviteteve ekonomike me interes publik. Sipas Ligjit për Ndërmarrje Publike (neni 10), këto NP që janë themeluar për kryerjen e shërbimeve komunale (siç janë përcaktuar me lartë në tekstin) quhen Ndërmarrje Publike për kryerjen e shërbimeve komunale ose Ndërmarrje Publike Komunale (NPK).

Vendimin për formimin e NPK-së e sjell Këshilli i Komunës. Me këtë vendim caktohen edhe kompetencat, përgjegjësitë dhe punët e NPK-së. Drejtorin e përgjithshëm të NPK-së e zgjedh Kryetari i komunës në bazë të konkursit, ndërsa anëtarët e Këshillit Drejtues dhe Bordin për Kontroll të Punës Financiare i emëron Këshilli i Komunës. Drejtori i përgjithshëm ka për obligim të firmos marrëveshje menaxheriale me kryetarin, në të cilin përcaktohen të drejtat, kompetencat në pajtim me ligjin. Këshilli i komunës i cakton programet punuese dhe planet financiare të NPK-së, por gjithashtu është përgjegjës edhe për miratimin e raporteve vjetore (operative dhe financiare) të NPK-së.

Këshilli Drejtues i NP-së: e sjell statutin e ndërmarrjes publike; vendos për ndryshimet statutoare dhe themelimin e shoqërive në pajtim me ligjin; i miraton programin për punë dhe zhvillimin e ndërmarrjes publike; e cakton politikën afariste; miraton llogarinë vjetore dhe raportin për punën e ndërmarrjes publike; vendos për përdorimin e mjeteve të realizuara me punën e ndërmarrjes publike dhe mbulimin e humbjeve; i sjell vendimet për investime; i cakton çmimet e produkteve

dhe shërbimeve; vendos për organizimin e brendshëm të ndërmarrjes publike dhe kryen punë tjera të caktuara në aktin për themelimin dhe statutin e ndërmarrjes publike.

Për kryerje të kontrollit të punës materiale-financiare të ndërmarrjes publike formohet bordi për kontrollin e punës materiale-financiare (bordi për kontroll) prej pesë anëtarëve. Anëtarët e bordit për kontroll i emëron, gjegjësisht i shkarkon themeluese me mandat prej 4 viteve si dhe anëtarët e Këshillit Drejtues.

Në pjesën më të madhe, komunat në RM vetëm më kanë formuar NPK. Megjithatë, forma dhe shtrirja e shërbimeve dallojnë shumë prej një komune në tjetër. Komunat më të mëdha urbane zakonisht kanë NPK më të mëdha me strukturë të ndërlikuar organizative dhe punojnë vetëm për veprimtari të caktuara komunale. Komunat më të vogla urbane dhe komunat rurale zakonisht formojnë një NPK që është përgjegjëse për zbatimin e më tepër shërbimeve komunale. Momentalisht, forma e dytë e NKP-ve dominon në RM. Me rëndësi të madhe është të theksohet NPK-të më të vogla, kryesisht në komunat rurale, kanë më pak kapacitete (teknike, drejtuese dhe financiare) dhe në numrin më të madh të rasteve kanë jo më tepër se 3-5 të punësuar. Thënë shkurt, NPK-të formohen dhe janë në pronësi të plotë të komunave. Gjatë kësaj, Kryetarët dhe Këshillat e komunave luajnë rol të rëndësishëm gjatë emërimit të organeve udhëheqëse të ndërmarrjes, që tregon menjëherë se ndikimi politik mbi gjithë punën e NPK-së nuk mund të shmanget, ndërsa posaçërisht reflektohet në caktimin e çmimeve për shërbimet komunale.

Për të përmirësuar shërbimet komunale, dhe njëherë edhe qëndrueshmërinë e sektorin komunal, së paku në pjesën e furnizimit dhe mbeturinave, gjatë vitit 2008 me mbështetjen e Bankës Botërore ishte hartuar “Strategjia dhe Plani i Veprimit për reforma në ndërmarrjet komunale me fokus në ujësjellje, kanalizim dhe trajtimin e mbeturinave të forta”. Sipas kësaj strategjie, janë të nevojshme reforma në strukturë institucionale në të cilën punojnë ndërmarrjet komunale për të përmirësuar furnizimin e shërbimeve përdoruesve dhe të zvogëlohen ngarkimet drejtpërdrejtë ose indirekte të qytetarëve. Sipas strategjisë, reformat në ndërmarrjet komunale duhet të përqendrohen në:

- Plotësimi i standardeve të Bashkimit Evropian në sektorin ujësjellje, kanalizim dhe trajtimi i mbeturinave të forta për Maqedonisë që të mund të “kualifikohet” për hyrje në BE;
- Të sigurohet që ndërmarrjet komunale dhe komunat janë të përgatitura për të absorbuar dhe menaxhuar me hyrjen e madhe të mjeteve nga projektet parahrëse në këtë dhe në sektorët tjerë për shërbime komunale (përfshirë edhe fleksibilitetin e përmirësuar dhe transparencën në rregullimet financiare mes ndërmarrjeve komunale dhe komunës)
 - ▶ Efikasiteti i rritur dhe cilësi më të madhe të furnizimit të shërbimeve;

- ▶ Rritje të transparencës, përgjegjshmërisë dhe reagimit të shpejtë ndaj nevojave të përdoruesve;
- ▶ Sigurimi i vetëfinancimit të shërbimeve bashkë me subvencionimin transparent.

Sipas strategjisë, në nivelin komunal, transparenca dhe përgjegjshmëria do të përforcoheshin shumë me ndarjen e funksioneve për krijimin e politikave, pronësi dhe rregullim. Në nivel të ndërmarrjeve komunale, një kusht i domosdoshëm është shpeshherë autonomia më e madhe për përgjegjshmëri dhe efektivitet më të madh. Në nivelin sektorial, përparësia e kompanive rajonale për ujësjellje do të ishte ajo ekonomike (duke përdorur përparësinë e ekonomisë në zhvillim) dhe politike (ndërprerje të lidhjes së afërt mes komunave dhe ndërmarrjeve të tyre komunale). Në një pjesë, ajo gjithashtu do të ishte edhe pjesë e përputhjes me direktivat e BE-së.

Kjo “situatë e qartë” është vizioni për strukturë ideale institucionale që është në kundërshtim me situatën aktuale, në të cilën nuk ekzistojnë kufij të qartë mes krijimit të politikës, furnizimit të shërbimeve dhe rregullimit nga ana e komunave dhe që ndërmarrjet komunale janë peng i themeluesit. Si rezultat i asaj, ka një pavarësi të vogël dhe përgjegjshmëri nga ana e furnizuesve të shërbimeve dhe vendimet shpeshherë janë të motivuar politikisht në vend që të udhëhiqen nga parimet e drejtimit të shëndoshë afarist, reagimit të shpejtë ndaj përdoruesve dhe efikasiteti ekonomik.


1.2 Shtrirja institucionale

Sipas mendimit të gjerë për shërbimet e ndryshme që bëjnë pjesë në grupin e veprimeve komunale dhe kornizën ligjore për kryerjen e këtyre kompetencave është më e madhe. Më tepër, dhe në drejtim të procesit të qasjes së RM-së në BE, pjesë e madhe e rregulloreve ligjore në veprimtaritë komunale duhet të përputhen me rregulloret dhe direktivat e BE-së që kanë të bëjnë me këto kompetenca. Duke marrë parasysh që veprimtaritë komunale në RM mbulojnë shumë segmente të rëndësishme nga legjislatura e BE-së që ka të bëjë me shërbime publike, mjedis jetësor, përputhje me kërkesat e rrepta të BE-së, paraqet një problem plotësues për komunat dhe NPK-të për shkak të kapaciteteve të pamjaftueshme financiare, kuadrove dhe teknike për plotësimin e këtyre kërkesave dhe zbatim i drejtë i rregulloreve ligjore.

Ligjet kryesore që drejtojnë shërbimet komunale janë: Ligji për Vetëqeverisje Lokale, Ligji për Zhvillim të Barabartë Rajonal, Ligji për Qytetin e Shkupit, Ligji për Financimin e Njësisve të Vetëqeverisjes Lokale, Ligji për Aktivitete Komunale, Ligji për Ndërmarrje Publike, Ligji për Mjedisin Jetësor, Ligji për Ujërat, Ligji për


Furnizim me Ujë të Pijshëm dhe Largimi i Ujërave të Zeza Urbane, Ligji për Trajtimin e Mbeturinave të Forta.⁸

Siç mund të vërehet nga lartë, një prej problemeve kryesore me kornizën juridike është ligjet e shumta që drejtojnë shërbimet komunale, ndryshimet e shpeshta të ligjeve si dhe numri i madh i institucioneve që janë përfshirë në procesin e krijimit, zbatimit dhe vëzhgimit të furnizimit të shërbimeve komunale siç është treguar në figurën më poshtë. Mund të priten ndryshime të mëtutjeshme si rezultat i përpjekjeve të Republikës së Maqedonisë për përputhjen e kornizës ligjore me direktivat e BE-së që kanë të bëjnë me shërbimet komunale. Për çështjen ndërlikuar flet edhe fakti që është hapur një Inspektorat i posaçëm në sajë të Ministrisë për Vetëqeverisje Lokale për të siguruar parimësi mes vendimeve komunale dhe rregulloreve dhe ligjeve kombëtare.



Në nivel të njësive të vetëqeverisjes lokale, përgjegjësia shpeshherë është e ndarë mes administratës komunale që në pjesën më të madhe i furnizon shërbimet administrative për qytetarët dhe NPK që i zbatojnë të a.q. shërbime “reale” komunale. Relacionet e tyre të përbashkëta janë shfaqur në tabelën më poshtë:

⁸ Të gjitha ligjet në gjuhën maqedonishte mund t'i gjeni në www.pravo.org.mk



Pjesa	Komuna	Ndërmarrja komunale
Pronësi mbi mjetet themelore	Rrjeti i mjeteve themelore (nëse nuk është në pronësi të shtetit)	Mjete të vogla themelore (makina, pajisje zyre, etj)
Emërimet	Këshilli e aprovon Këshillin Drejtues dhe Vëzhgues. Kryetari e emëron drejtorin e përgjithshëm	
Rregullim të tarifës	Tarifat i aprovon Këshilli	Tarifat i propozojnë ndërmarrjet komunale
Marrëdhënie financiare	Këshilli i aprovon llogaritë vjetore të ndërmarrjeve komunale	Ndërmarrjet komunale japin faturë komunave për sigurimin e shërbimeve (p.sh. ujin që përdor komuna); mund të merr subvencione për mallra publike (p.sh. parqe)
Financimi i investimeve kapitale	Këshilli duhet të aprovojë dhe komuna jep garanci për çdo borxhmarrje të ndërmarrjes publike; MF-ja duhet të aprovojë garancinë, vetëm të ardhurat e komunave konsiderohen në kufirin e servisimit të borxhit (jo të ardhurat e NP-së)	NP-ja mund të firmos marrëveshje për borxhmarrje vetëm me aprovimin e Këshillit të komunës dhe MF-së
Praktikë kontabiliteti	Norma në komunat është kontabël me para	Norma në NP-të është kontabilitet në arritje
Marrëveshje për bashkëpunim të jashtëm dhe koncesion	Komunat japin leje/ marrëveshje/koncesione për shërbime komunale	
Standarde teknike	Inspektorati komunal/ republikan	

Ndonëse gjitha kompetencat e veprimtarisë komunale kanë rëndësi të madhe për jetën e përditshme të qytetareve, por serish ujësjellje dhe trajtimi me mbeturina ndahen si shërbime më të shpeshta komunale, andaj më poshtë jepet një fokus më të hollësishëm.



1.3 Korniza ligjore

Analiza e legjislaturës në këtë fushë tregon se prej fillimit të qasjes në BE, sfida kryesore për Qeverinë ka qenë përputhja e legjislaturës me kërkesat e direktivave të BE-së në këtë fushë. Si rezultat i këtyre përpjekjeve është edhe miratimi i Ligjit të ri për Ujëra, që përfshin shumë ndryshime në politikën dhe reforma institucionale. Në lidhje me ujësjellje dhe kanalizim, ligjet tjera duhet të merren parasysh: Ligjin për Ndërmarrje Publike, Ligjin për Veprimtari Komunale, Ligjin për Ujësjellje dhe largimi i ujërave të zeza urbane dhe Ligjin e Ujërave.

Ligji për ndërmarrje publike ju jep kompetenca njësive të vetëqeverisjes publike që të krijojnë Ndërmarrje Publike Komunale (NPK), që të emërtojnë Drejtorë të Përgjithshëm dhe organe për drejtim dhe të miratojnë buxhetin e ndërmarrjes. Gjithashtu, neni 4 prej Ligjit për Ndërmarrje Publike i lejon themeluesit (Këshillit të komunës) të merr vendime për transformim të NPK-së në shoqatë aksionare (SHA) ose shoqatë me përgjegjësi të kufizuar (SHPK). Sidoqoftë, në praktikë nuk ka numër të madh të transformimeve të tilla. Shërbimet komunale rregullohen në më shumë detaje me një lloj „ombrelle“, rregullohen kushtet themelore dhe mënyra e kryerjes dhe financimit të shërbimeve komunale.

Me Ligjin për Ujësjellje dhe Largimin e Ujërave të Zeza Urbane (Gazeta Zyrtare RM, 68/2004) rregullohen kushtet dhe mënyra e furnizimit me ujë të pijshëm, ndërprerja furnizimit me ujë të pijshëm dhe Largimi i ujërave të zeza urbane tek përdoruesi nëpërmjet sistemit për furnizim me ujë dhe kanalizim, ndërtimin, mirëmbajtjen, mbrojtjen dhe kyçjen në për furnizim me ujë dhe kanalizim, marrëdhëniet mes dhënësit dhe përdoruesit të shërbimit, si dhe mbikëqyrje mbi zbatimin e këtij ligji. Dhënësi i shërbimit është i obliguar vazhdimisht të siguron pajisje me ujë të shëndetshëm, pastër dhe të pijshëm nëpërmjet sistemit për furnizim me ujë, si dhe largimi i ujërave të zeza urbane nëpërmjet sistemit të ndërtuar për kanalizim. Gjithashtu, dhënësi i shërbimeve është i obliguar të kryen testet e kontrollit për rregullsinë shëndetësore të ujit sipas mënyrave dhe procedurave që janë në pajtim me rregulloret ligjore.

Mjetet për kryerjen e këtyre veprimtarive realizohen nga çmimi për shfrytëzimin e këtyre shërbimeve dhe kompensimit për kyçje në sistemin për furnizim me ujë dhe kanalizim. Çmimi i ujit të pijshëm dhe largimi i ujërave të zeza urbane dhe ujërave atmosferike shprehen në den/m³ dhe varen prej shpenzimeve për furnizim me ujë të pijshëm deri tek shfrytëzuesit e shërbimit dhe largimin e ujërave të zeza urbane, shpenzimet për mbrojtje të mjedisit jetësor rreth burimit, të vet burimit, shpenzime për përdorim, shpenzime për mirëmbajtje, ndërrim i pjesëve të amortizuara dhe dëmtime tjera, investime kapitale, kamatat për pagesë të investimeve kapitale dhe shpenzimeve tjera. Shuma e kompensimit varet prej madhësisë së kyçjes në ujësjellës, gjegjësisht kanalizim, shpenzimet për kyçje, kushtet hidroteknike, e tjerë.

Pajtimi për shumën e çmimit si dhe të kompensimi për kyçje jepet nga themeluesi (Këshilli i komunës).

Përcaktimi i vlerës së çmimit kryhet me Metodologji, në bazë të kriterëve në vijim: sasia e harxhuar e ujit të pijshëm nga ana e përdoruesve të shërbimit, harxhimi mesatar dhe i tepruar dhe kategoritë e përdoruesve të shërbimit.

Shpenzimi i ujit të pijshëm, si shpenzim mesatar sipas numrit të anëtarëve të amvisërisë së familjes përcaktohet nga këshilli dhe qyteti i Shkupit, ku çmimi për secilin metër kub ujë të pijshëm të harxhuar mbi vlerën mesatare të harxhimit (harxhim i tepruar i ujit të pijshëm) rritet për dy herë.

Ndërtimi i sistemeve për ujësjellje dhe kanalizimeve zbatohet në mënyra dhe kushte të rregulluara me këtë ligj por edhe me ligjet tjera (p.sh. Ligji për Ndërtim), si dhe me Programet për rregullim të tokës ndërtimore në komunat dhe qytetin e Shkupit. Ligji për ndërtim (Gazeta Zyrtare, 51/05) definon se leja për ndërtim të sistemeve rajonale për furnizim me ujë lëshohet nga organi kompetent për rregullimin e tokës ndërtimore në nivel qendror (MTL), derisa sistemet lokale për furnizim me ujë ndërtohen në bazë të lejeve për ndërtim që i jep komuna. Në numrin më të madh të rasteve, sistemi që mbulon territorin e dy ose më shumë komunave konsiderohet si sistem rajonal.

Secili pronar i objektit pjesërisht ose tërësisht të ndërtuar, është i obliguar të lidh kanalizimin e shtëpisë me kanalizimin e rrugës, atëherë kur kanalizimi i rrugës do të ndërtohet para objektit të tij/saj. Sidoqoftë, kjo nuk vlen edhe për sistemet për furnizim me ujë, ku ka disa shembuj me qytetar që refuzojnë të bashkëngjiten sistemeve të reja të ndërtuara për ujësjellje.

Sistemi për furnizim me ujë ose kanalizim i ndërtuar me mjetet e qytetarëve, donatorëve të vendit ose të huaj ose përdoruesve tjerë, me marrëveshje i dorëzohet për drejtim dhënësit të shërbimit dhe paraqet tërësi të sistemit të vetëm për ujësjellje ose kanalizim. Sidoqoftë, ligji nuk trajton drejtimin e disa sistemeve vetëm më të ndërtuara, nëse komuna nuk ka themeluar NPK ose ajo nuk është kompetente të drejton me ato sisteme në suaza të komunës. Që të eliminohet ky problem, një nga mundësitë është të kërkohet nga komunat të obligojnë NPK e përhershme me përgjegjësinë për drejtim me sistemet edhe në këto rajone rurale, ose të formohet NPK e re, e posaçme për rajonet rurale. Në lidhje me këtë, BNJVL vetëm më ka ndërtuar qëndrim të përbashkët (shih pjesën mbi Rekomandime).

1.3.1 Ujësjellje dhe kanalizim

Si shtet kandidat për anëtarësim në BE, RM bën një përparim të dukshëm në harmonizimin e legjislaturës kombëtare Direktivën Kornizë për Ujëra të BE-së dhe me direktivat tjera për furnizim me ujë dhe kanalizim. Në Ligjin e ri për Ujëra pjesa më e madhe e kërkesave të BE-së janë përfshirë në legjislaturën kombëtare.

Sidoqoftë, sfidon zbatimi konsekuent i ligjit dhe akteve nënligjore. Kjo edhe më tej ndërlikohet me faktin se në sigurimin e shërbimeve për furnizim me ujë dhe kanalizim përfshihen institucione të ndryshme, si në nivel lokal ashtu edhe në nivel qendror. Në tabelën më poshtë janë dhënë kompetencat e institucioneve të ndryshme gjatë sigurimit të shërbimeve nga furnizimi me ujë dhe kanalizimi:

Detyra \ Institucioni përgjegjës	NKP	Kryetar komune	Këshill komune	MMJPH	MTL	MB	ME
Aktivitetet e ndërlidhura me NKP							
Formimi i NKP			x				
Emërimi i organeve drejtuese, Këshillit Drejtues i Këshillit për kontroll të punës materiale-financiare			x				
Emërtim dhe shkarkim të Drejtorit të Përgjithshëm të NKP		x					
Vendimi për transformim të SHP në SHA			x				
Vendimi shpërbërjen e SHP			x				
Pëlqim për : Statutin e SHP dhe ndryshimet e saja; akti për përdorimin e mjeteve financiare të realizuara nga puna e SHP si dhe mbulim i humbjeve; vendim për detyrimet financiare nga ana e SHP; përcaktimi i çmimeve të shërbimeve; raportet vjetore mbi punën dhe llogaritë përfundimtare të SHP; programet e investimeve të SHP në përputhje me zhvillimin e përgjithshëm ekonomik			x				
Përcaktim i kushteve për shpërndarjen e mjeteve të realizuara si profit			x				
Aktivitetet e lidhura me shërbimet							
Përcaktimi i harxhimeve mujore sipas numrit të anëtarëve të familjes			x				
Miratimi i planit për restriksione të ujit			x				
Përcaktimi i çmimeve të shërbimeve të NKP	x						
Përcaktimi i kompensimeve për kyçe në sistemet për furnizim me ujë dhe kanalizim	x						

Detyra \ Institucioni përgjegjës	NKP	Kryetar komune	Këshill komune	MMJPH	MTL	MB	ME
Informimi i përdoruesve për ndërprerje të planifikuar të shërbimit	x						
Testet e kontrollit për rregullsinë shëndetësore të ujit	x						
Dhënia e kushteve hidro-teknike për rekonstruktimin ose ndërtim plotësues të sistemeve për furnizim me ujë dhe kanalizim	x						
Dizajnim dhe revizion i sistemeve të përhershme me qëllim të themelimit dhe mirëmbajtjes së kadastrës nëntokësore	x						
Verifikimi i instrumenteve ujore - ujëmatës	x						
Përcaktimi i llojit dhe dimensioneve të ujëmatësve	x						
Ndërprerja/shkyçja nga sistemi për furnizim me ujë dhe kanalizim	x						
Nënshkrimi i kontratave me përdoruesit e fundit të shërbimeve	x						
Dhënia e lejeve ujore për shfrytëzim të ujit				x			
Dhënia e mendimit mbi përdorimin e lejeve ujore		x					
Përgatitja e programit për largimin dhe trajtimin e ujërave të zeza urbane		x		x	x		
Zhvillimi, drejtimi dhe mirëmbajtja e sistemit efikas dhe ekonomik për furnizim me ujë, duke siguruar sasi të mjaftueshme të ujit të pijshëm për të gjitha objektet legale		x					
Mbikëqyrje dhe inspektim							
Mbikëqyrje mbi zbatimin e ligjeve			x	x	x	x	x
Inspektim i dorëzimit të vazhdueshëm dhe pandërprerë të ujit		x			x		x
Inspektim i cilësisë së ujit të pijshëm		x				x	x

Detyra \ Institucioni përgjegjës	NKP	Kryetar komune	Këshill komune	MMJPH	MTL	MB	ME
Inspektim i cilësisë së ujërave të zeza që lëshohen nga përdoruesi		x		x			
Vëzhgim i ujit të paraparë për pirje, kompajlim dhe ruajtje të dhënave						x	

Legjenda: MMJPH – Ministria për mjedis jetësor dhe planifikim hapësinor, MSH – Ministria e Shëndetësisë; MTL – Ministria e Transportit dhe Lidhjeve; ME – Ministria e Ekonomisë; MBPEU – Ministria për bujqësi, pylltari dhe ekonomi të ujit

Kryetari i komunave, kryetari i komunave në qytetin e Shkupit dhe kryetari i qytetit të Shkupit janë të detyruar të sigurojnë zhvillim dhe mirëmbajtje të sistemit efikas dhe ekonomik për furnizim me ujë të pijshëm në sasi të mjaftueshme dhe cilësi të kënaqshme. Në prill të vitit 2008 u miratua Rregullorja për siguri të ujit (Gazeta Zyrtare, 46/08), që në tërësi ka përfshirë kërkesat e Direktivës së BE-së numër 98/83/EC nga 3 nëntor të vitit 1998, dhe ka të bën me cilësinë e ujit të pijshëm për njeriun.

Largimi i ujërave të zeza nënkupton mbledhjen, largimin, spastrimin dhe lëshimin e ujërave të zeza nga efluentët, si dhe të rrëkeve të mbledhura nga vërshimet atmosferike në vendet e urbanizuara. Largimi përfshin edhe infiltrimin nëntokësor ose ujitjen e tokës me ujëra të zeza, si dhe largimin e llucës së fituar me spastrimin e ujërave të zeza.


Komuna, komunat e qytetit të Shkupit dhe qyteti i Shkupit janë të obliguar të mbledhin, largojnë dhe spastrojnë ujërat e zeza që dalin ose krijohen në hapësirën e tyre, përfshirë edhe largimin e llucës, si dhe të sigurojnë që:

- ▶ ndërtesa të projektohen, ndërtohen, përdoren dhe mirëmbahen në mënyrë që siguron punë të suksesshme në kushte të zakonshme klimatike;
- ▶ ujërat e zeza të spastruara dhe lluca e fituar me trajtim të ujërave të zeza, të shfrytëzohen përsëri, kur ajo është e përshtatshme, dhe
- ▶ largimi i ujërave të zeza dhe llucës nuk duhet të krijojë ndikime negative ndaj mjedisit jetësor.

Komunat, komuna e qytetit të Shkupit dhe qyteti i Shkupit janë të detyruar të sigurojnë:

1. ekzistimi i sistemi për mbledhjen e ujërave të zeza në secilin vendbanim me më shumë se 2.000 nji/b dhe spastrimi i përshtatshëm i ujërave të zeza para lëshimit në ujërat për përdorim, jep një nivel të shërbimit që i kënaq qëllimet

për cilësi;



2. spastrim përkatës i të gjitha ujërave të zeza që lëshohen nga sistemet për mbledhje të ujërave të zeza nga vendbanimet me më pak se 2000 nj/b; dhe
3. spastrim dytësor (biologjik) ose spastrim i ngjashëm për spastrimin e ujërave të zeza nga sistemet për mbledhjen e ujërave të zeza nga vendbanimet me më shumë se 2000 nj/b, në rast se ujërat e zeza lëshohen në zona të ndjeshme ndaj lëshimit të ujërave të zeza urbane.

Personi juridik që udhëheq me sistemin e furnizimit me ujë (shpeshherë është NPK) ka për obligim të instalon dhe mirëmban në gjendje të kënaqshme instrumentet për matje dhe analizë të cilësisë të ujit të patrajtuar në gjendjen burimore, ujin e spastruar pas dezinfektimit.

Gjithashtu, personat juridik që sigurojnë furnizimin me ujë mund të ndërpresin shërbimin, nëse ka nevojë për intervenime ndaj sistemit ose përdoruesi ka obligime financiare për të paguar, por nuk i shlyen në afatin e paraparë, por pas dorëzimit të vërejtjes. Sipas parimeve, përdoruesi paguan, nëpërmjet çmimit të ujit do të mundësohet që përdoruesit e ujit të përdorin ujin në mënyrë efikase për shkak të kontributit ndaj realizimit të qëllimeve të mjedisit jetësor në mënyrë që përdoruesit e ndryshëm të ujit do të paguajnë kompensime përkatëse.

Çmimi i shërbimeve për përdoruesit e fundit përfshinë shpenzimet për sigurimin e shërbimit, shpenzimet për mjedisin jetësor dhe shpenzimet e burimit në pajtim me parimin „mbulim të shpenzimeve/përdoruesi paguan“. Gjithashtu, çmimi përfshin gjitha shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes, nevojat rezerve për ndërrimin e pjesëve të vjetra, pajisjen, shpenzimet kapitale për pagesa me këste dhe kamatat e kredive, si dhe shpenzimet tjera.

1.3.2 Mbeturinat komunale

Strategjia për trajtimin me mbeturinat në RM 2008-2020 e pasqyron politikën kombëtare për menaxhimin me mbeturina dhe paraqet një bazë për përgatitjen dhe për zbatimin e sistemit të integruar për trajtimin e mbeturinave, që do të jetë më efektiv në lidhje me shpenzimet. Sipas strategjisë, problemet më të mëdha dhe kufizimet në fushën e menaxhimit me mbeturina në Republikën e Maqedonisë janë prezent pothuaj në gjitha fushat e sistemit aktual të menaxhimit me mbeturina si dhe në gjitha marrëdhëniet në shoqërinë që kanë të bëjnë me menaxhimin me mbeturina: korniza politike dhe ligjore; organizimi i institucioneve dhe resurseve njerëzore, mbulimit të shpenzimeve dhe financimin e shërbimeve dhe investimeve, vetëdija e subjekteve të përfshira dhe informimi i tyre, gjitha fazat e menaxhimit teknik nga grumbullimi deri në deponimin e mbeturinave, ekzistim/sanacion të ngarkesave të mjedisit jetësor, ndikimet mbi shëndetin e njerëzve dhe mbi kafshët/mjedisi natyror me ndikimin potencial mbi ekonominë maqedonase.

Gjendja momentale me mbeturinat në Maqedoni mund të karakterizohet si nën standarde në kuptim të resurseve njerëzore dhe financiare, si dhe e pamjaftueshme

dhe joefektive në kuptim të monitorimit dhe zbatimit të dispozitave që rezultojnë në sisteme të ndryshme jofunksionale në shoqërinë dhe në shumë efekte të ngjashme negative mbi mjedisin jetësor dhe shëndetin e njerëzve.

Rregullorja themelore kombëtare ligjore për trajtimin me mbeturina gjendet në Ligjin për Trajtimin me Mbeturina, që paraqet një akt ligjor dhe i përcaktohen rregullat themelore që zbatohen për çështjet kryesore në lidhje me mbeturinat dhe mbeturinat e rrezikshme. Gjithashtu, ligji siguron edhe bazë ligjore për sjelljen e shumë akteve nënligjore, por një pjesë e tyre mungojnë ose janë sjellë në formë të rregulloreve ose drejtimeve. Ligji për Trajtimin e Mbeturinave ka lidhje të rëndësishme me akte tjera ligjore që i rregullojnë detyrat dhe kompetencat në fushën e çështjeve organizative dhe operative në sferën e menaxhimit me mbeturina, posaçërisht me Ligjin për Mjedisin Jetësor, që i përmban dispozitat themelore për leje ekologjike, procedurën për vlerësimin e ndikimeve mbi mjedisin jetësor, emisionet e gazrave.

Sipas ligjit, komunat janë përgjegjëse për detyra të mëdha dhe vëllimore në lidhje me trajtimin e mbeturinave, por një numër i tyre kanë të caktuar departamente/persona në strukturën e tyre administrative dhe kanë marrë trajnimin e duhur. Nëse shikohen detyrat dhe kompetencat në nivelin shtetëror dhe lokal, në gjitha institucionet e MMJPH, ministritë tjera, komunat dhe sektori prodhues/shërbyes që kanë kompetenca për zbatimin e detyrave themelore të trajtimit me mbeturina ju mungojnë resurse njerëzore, njohuri dhe përvojë edhe për zbatimin e rregulloreve të plota ligjore, të standardeve, instrumenteve dhe investimeve për vendosjen e një sistemi të integruar të trajtimit të mbeturinave.

Me procesin e decentralizimit në vend, shumë kompetenca kanë qenë deleguar komunave. Komunat janë përgjegjëse për aktivitete të rëndësishme në sektorin mbeturina, si p.sh.: organizimi i grumbullimit, transportit dhe deponimit të mbeturinave komunale; vëzhgim mbi transportin dhe deponimin e mbeturinave industriale, sjellja e vendimeve për lokacionin e kapaciteteve për menaxhimin me mbeturina, miratimi i dispozitave për trajtimin e mbeturinave në nivelin lokal, financimi dhe vëzhgimi i mbylljeve të deponive të paligjshme dhe mbyllje të kapaciteteve për menaxhimin me mbeturina. Njëherë, komunat japin edhe leje ndërtimi për një pjesë të investimeve infrastrukturore, japin leje ekologjike B-integruese.

Hapja e deponive për mbeturina të parrezikshme dhe inerte është gjithashtu përgjegjësi e komunave; mirëpo, dhënia e lejeve, inspektimi dhe vëzhgimi në lidhje me çështjet e domenit të mbrojtjes së mjedisit jetësor, me përjashtim të deponive për mbeturina inerte, është përgjegjësi e MMJPH-së. Mirëpo, vetëm një pjesë e komunave kanë formuar departamente ose persona të caktuar për menaxhim me mbeturinë në strukturën administrative; do të duhen më tepër përpjekje për të vendosur institucionet lokale administrative dhe profesionale, si dhe organizatat

operative në nivelin rajonal, që duhet të pranohen nga gjitha palët e interesuara dhe komuna të kyçura.

Financimi i shpenzimeve për menaxhim me mbeturinat e forta komunale sigurohet nëpërmjet kompensimet që i paguajnë përdoruesit e shërbimeve për mbledhjen e bërrllokut. Këto kompensime faturohen dhe paguhen drejt nga ndërmarrjet komunale. Sistemi momental për pagesë të kompensimeve për përdorimin e shërbimeve për trajtimin e mbeturinave komunale janë të bazuar në kompensim fiks për m2 të shtëpisë/banesës ose kompensim të drejtë (paushall) për amvisëri/muaj. Sipas strategjisë, problemet kryesore në lidhje me kthimin e vazhdueshëm të shpenzimeve dhe financimit janë: (1) kompensimet për shërbimet që i paguajnë amvisëritë dhe krijuesit tjerë të mbeturinave komunale janë relativisht të ulët (dalohen dukshëm në pjesë të ndryshme të vendit) por edhe përkaj kësaj, përqindja e mospaguesve mesatarisht është i lartë; (2) caktimi i tarifave për mbeturinat komerciale dhe industriale është kryesisht e bazuar në m2 sipërfaqe të mbuluar ose kompensim të drejtë mujor; jo shpesh kompensimet bazohen në madhësinë e kontejnerit ose caktohen për secilin rast në veçanti; (3) tarifat i cakton secila komunë, por ato bazohen në atë që konsideron se është e pranueshme dhe jo shpenzimet e vërteta për sigurim të shërbimeve; (4) në pjesën më të madhe të rasteve, tarifat aktuale/shuma të kompensimit nuk i mbulojnë as shpenzimet për sigurimin e shërbimeve dhe kapacitetet e ndërmarrjeve komunale, ndërsa shpenzimet për zhvillim dhe zbatim të sistemeve të reja dhe kapaciteteve për menaxhim me mbeturina në pajtim me standardet e BE-së nuk janë përfshirë; (5) shpenzimet e vërteta për sigurimin e shërbimeve dhe kapaciteteve për menaxhim me mbeturina nuk janë të njohura për dhënësit e shërbimeve ose merren vesh nga përdoruesit e shërbimeve; (6) ndërmarrjet komunale/dhënësit e shërbimeve janë kryesisht joefikas gjatë përdorimit të mjeteve, kryesisht si konsekuencë e mungesës së shtypjes nga konkurrenca; (7) marrëdhëniet mes komunave, që kanë përgjegjësi ligjore të organizojnë shërbimet për mbledhjen dhe largimin e mbeturinave për qytetarët e tyre dhe dhënësit e shërbimeve (për momentin pothuaj në gjitha rastet, ndërmarrjet publike komunale) janë jotransparente dhe mungon përgjegjshmëri; (8) komunat janë shumë të kufizuar në aftësinë e tyre të mobilizojnë mjete financiare për investime kapitale për infrastrukturë dhe pajisje për menaxhim me mbeturina dhe nuk duket se gjendja mund të ndryshojë në të ardhmen e afërt; (9) pagesa me forcë e kompensimeve për shërbimet nuk mund të bëhet për shkak të zgjidhjeve ligjore, të cilat japin prioritet mbrojtjes së përdoruesit individual mbi interesin publik.



1.4 Perceptimi i qytetarëve për shërbimet komunale


Në kuadër të projektit “Decentralizim Transparent dhe Efikas” ishin realizuar hulumtime në teren për kënaqësinë e qytetarëve për shërbimet që i marrin nga komunat⁹. Ishin përfshirë gjithsej 12 partner komuna 1755 (2010) dhe 1.759 (2011) qytetarë. Në tabelën më poshtë janë dhënë vlerat mestarë për veprimtari komunale në vitin 2010 dhe 2011 sipas perceptimit të qytetarëve:

	2010	2011
Veprimtari komunale	2,90	2,94
Ndriçimi publik rrugor	3,29	3,32
Ujësjellje dhe kanalizim	3,30	3,24
Trajtim i mbeturinave (largim, transport dhe deponim)	3,36	3,23
Parqe dhe sipërfaqe të gjelbër	3,18	3,18
Tregjet e mëdha (tregje jeshile)	3,16	3,14
Rrugë lokale dhe rrugë dhe sinjalizimin rrugor	3,01	3,08
Rregullimi i trafikut dhe transportit publik	2,99	3,03
Mirëmbajtje të varrezave	2,76	2,89
Mirëmbajtje të shtretërve të lumenjve	2,61	2,65
Mirëmbajtje të kanaleve për ujtitje/përçim	2,56	2,65
Hapësira parkimi	2,50	2,62
Trajtimi i kafshëve rrugor	1,94	2,14

Shërbimet komunale në Republikën e Maqedonisë tradicionalisht janë shërbime të përgjegjësive lokale. Me siguri, pikërisht për këtë fakt, vlerat mesatare në dy vitet e analizuara janë shumë të ngjashme madje edhe identike. Mirëpo, për të shënuar është fakti se ulje më të madhe në vitin 2011 vërehet në shërbimin për trajtimin me mbeturina (prej 3,36 në 2010 në 3,23 në 2011), dhe njësoj ulje vërehet edhe në shërbimet për ujësjellje dhe kanalizim dhe tregjet jeshile. Duke marrë parasysh që përgjegjës të drejtpërdrejtë për këto shërbime janë Ndërmarrjet Publike Komunale, tregon se qytetarët në vitin 2011 janë më pak të kënaqur nga puna e NPK për dallim nga viti 2010, ndonëse këto shërbime ende janë lartë në listën e kompetencave të veprimtarive komunale. Në dy vitet e analizuara edhe më tutje më dobët të notuar


9 http://soros.org.mk/dokumenti/sledenje_decentralizacija_mk_web.pdf

janë mirëmbajtja e kanaleve për ujë/përçim, hapësirat për parkim dhe trajtimi i kafshëve rrugore.



- Çmimet për ujësjellje dhe kanalizim janë:
1. Ultë
 2. Normale/të pranueshme
 3. Lartë
 4. Nuk e di/s'ka përgjigje

Në lidhje me çmimet për shërbimet komunale për ujësjellje dhe kanalizim, mendimet janë pothuaj identike në dy vitet e analizuara. Përfundimi i përgjithshëm është se shumë qytetarë mendojnë se çmimet janë ose normale (44,06% në 2010, 40,06% në 2011) ose të larta (45,25% në 2010, 43,15% në 2011), ndërsa një përqindje e vogël e qytetarëve mendojnë se çmimet për ujësjellje dhe kanalizim janë të ulëta (3,58% në vitin 2010, 8,71% në vitin 2011).



- Çmimet për mbeturina dhe pastërti janë:
1. Ultë
 2. Normale/të pranueshme
 3. Lartë
 4. Nuk e di/s'ka përgjigje

Në lidhje me shërbimet komunale për mbeturina, njësoj sikur me ujësjellje dhe kanalizim, mendimet janë pothuaj identike në dy vitet e analizuara. Përfundimi i përgjithshëm është se shumë qytetarë mendojnë se çmimet janë ose normale (48,11% në 2010, 44,66% në 2011) ose të larta (33,94% në 2010, 35,38% në 2011). Përqindja është e vogël e qytetarëve që mendojnë se çmimet për mbeturina dhe pastërti publike janë të ulëta.



2. Analiza e rezultateve nga monitorimi i veprimtarive komunale në RM për vitin 2011

2.1 Indeksi i veprimtarive komunale

Indeksi i veprimtarive komunale (IVK) për vitin 2011 është njehsuar sipas metodologjisë që përdoret për monitorimin e decentralizimit dhe është 2.93 që është identik me indeksin e perceptimit të qytetarëve për cilësinë e shërbimeve komunale (2.94). Duhet të theksohet se ndonëse shërbimet komunale janë një lloj “vendas” në kompetencat, ato çdoherë kanë qenë kompetencë e vetëqeverisjes lokale, vlera e indeksit të decentralizimit në veprimtaritë komunale është më e vogël se indekset e arsimit dhe urbanizimit, kompetenca që ishin decentralizuar pas vitit 2005. **Përfundimi i përgjithshëm që mund të nxirret është se komunat tregojnë rezultate të kënaqshme në organizimin dhe furnizimin e shërbimeve komunale, por që ju paraprin një sfidë e madhe për plotësimin e suksesshëm të rregulloreve të rrepta të BE-së në sektorin, posaçërisht në pjesën e ujit dhe mbeturinave si dhe që komunat kanë nevojë për mjete më të mëdha financiare për të mirëmbajtur dhe zhvilluar sektorin komunal.** Një përfundim i tillë e imponon nevojën që urgjentisht të dedikohet vëmendje të posaçme veprimtarive komunale si nga pushteti lokal ashtu edhe qendror, si dhe sektori qytetar.

Nën-indekset që e formojnë indeksin e veprimtarive komunale (IVK), faktorët e tyre peshues si dhe notat përkatëse për vitin 2011 janë dhënë në tabelën më poshtë.

	Nën-indekse	Faktori peshues	RM 2011
1.	NI 1: Zbatimi i politikave për decentralizim në veprimtarinë komunale	22%	2,75
2.	NI 2: Gjendja financiare e komunave për organizimin e shërbimeve komunale	34%	2,34
3.	NI 3: Performanca të shërbimeve të komunës në veprimtarinë komunale	29%	3,15
4.	NI 4: Transparenca dhe përgjegjshmëria gjatë furnizimit të shërbimeve komunale	15%	4,13
		IVK	2,93

Siç mund të vërehet nga tabela, secili nën-indeks merr pjesë me peshë të veçantë në formimin e IVK-së, d.m.th. sipas mendimit të nëpunësve përkatës shtetëror dhe kryetarët e partner-komunave peshë më të madhe dhe vlerësim ka nën-indeksi për gjendjen financiare të komunave për organizimin e shërbimeve komunale.

Zbulimet kryesore nga monitorimi i decentralizimit në veprimtaritë komunale për vitin 2011 janë këto më poshtë:

- Nga njëra anë, ndikim më të madh mbi organizimin dhe zbatimin e veprimtarive komunale, njësoj sikur me kompetencat tjera (përveç ZEL) ka gjendja financiare e komunës. Por, rezultatet më të dobëta janë arritur në matjen e indikatorëve financiarë, që tregon për gjendjen e keqe financiare në sektorin.
- Nota relativisht e larë (3.15) për performancat e veprimtarive komunale me siguri është si rezultat i përvojës afatgjate në furnizimin e këtyre shërbimeve nga ana e komunës, por edhe fakti që në këtë analizë theksi më i madh ishte vendosur mbi shërbimet tradicionale komunale – ujësjellje, kanalizim dhe mbeturina. Organizimi i disa shërbimeve më specifike (p.sh. pastrimi i oxhaqeve, trajtimi i kafshëve rrugore, largimi i makinave të vjetra, etj.) nuk janë marrë parasys.
- Notë më të madhe në furnizimin e veprimtarive komunale kanë marrë transparenca dhe përgjegjshmëria e komunave, para së gjithash për plotësimin e kërkesave minimale ligjore për punë transparente dhe të përgjegjshme.

Me poshtë është dhënë përshkrim i hollësishëm i secilit nën-indeks për indikatorët që e formojnë atë nën-indeks. Njëherë është dhënë përshkrim për secilin prej indikatorëve dhe pastaj edhe nota mesatare e gjitha komunave për vitin 2011.

2.2 Nën-indeks për zbatimin e politikave

Faktori peshues i këtij nën-indeksi është 22%, ndërsa vlerat peshues të secilit prej indikatorëve që formojnë këtë nën-indeks janë dhënë në tabelën më poshtë, prej ku edhe vërehet rëndësi më të madhe (peshë) ka indikatorin 1.3 (45%), që ka të bëjë me politikat e borxhmarrjes së komunave. **Kjo informatë tregon që për të zbatuar mirë politikat në veprimtarinë komunale (posaçërisht ata që janë përputhur me rregulloret e BE-së në sektorin, si për shembull, ujë dhe mbeturina) komunat kanë nevojë të menjëhershme të mjeteve financiare që nuk mund të sigurojnë me instrumentet momentale fiskale që kanë në dispozicion, por duhet të sigurohen nëpërmjet borxhit.**

Vlera e këtij nën-indeksi dhe indikatorëve që formojnë, bashke me vlerat përkatëse mesatare dhe notat e gjitha komunave të analizuara për vitin 2011 janë dhënë në tabelën më poshtë:

INDIKATOR / faktori peshues (%)	2011	
	Nota mesatare	NI 1
1.1. Mbështetja institucionale e pushtetit qendror për shërbimet komunale – 27%	3,12	2,75
1.2. Konsultim i komunave gjatë sjelljes së politikave kombëtare në veprimtaritë komunale – 28%	2,80	
1.3. Politika për borxhmarrje të komunave – 45%	2,50	

Indikator 1.1: Mbështetja institucionale e pushtetit qendror për shërbimet komunale

Ky indikator tregon si komunat e vlerësojnë mbështetjen institucionale (ligjet, kyçje në proceset, etj) që e siguron pushteti lokal për stimulimin dhe zhvillimin e sektorit komunal. Faktori peshues është 27% dhe është më i vogël në krahasim me vlerat peshuese të dy indikatorëve tjerë që sugjerojnë se politikat kombëtare në sektorin japin bazë cilësore për zbatimin e kompetencës, por që rëndësi më të madhe ka elementi financiar. Vlera e këtij indikator është fituar në bazë të perceptimit të nëpunësve përkatës shtetëror dhe partner-komunave që kanë vlerësuar ndikimin e politikave aktuale të pushtetit qendror në lidhje me variablat më poshtë:

- Politikat ekzistuese (ligje, rregullore...) të pushtetit qendror për zbatimin e pandërprerë të kompetencave për veprimtari komunale;
- Ndikimi i ligjeve për ujë dhe trajtimi i mbeturinave dhe aktet nënligjore që dalin nga ata;

- Mbështetje të politikave ekzistuese për bashkëpunimin ndër-komunale gjatë stimulimit të furnizimit të shërbimeve të përbashkëta komunale në më tepër komuna.

Nota mesatare e këtij indikatorit është 2.80, ndërsa rezultatet tregojnë që **komunat mendojnë se politikat ekzistuese në sektorin komunal janë në nivelin e duhur dhe që pjesa më e madhe janë në përputhje me kërkesat e BE-së, por nga ana tjetër, janë të vetëdijshëm që zbatimi i tyre në nivelin lokal është e vështirë për shkak të mungesës së kapaciteteve lokale (institucionale, financiare dhe kuadro). Sipas rezultateve të fituara, komunat mendojnë se zbatimi i drejtë i Ligjit mbi Ujërat është sfida më e madhe, ndërsa janë më pak të kënaqur me nivelin e konsultimit gjatë sjelljes së politikave kombëtare (shtetërore) në pjesën e veprimtarive komunale.**

Indikator 1.2: Konsultim i komunave gjatë sjelljes së politikave kombëtare në veprimtaritë komunale

Ky indikator tregon se në çfarë mase pushteti qendror i konsulton komunat gjatë sjelljes së politikave shtetërore në veprimtarinë komunale (ligje, strategji, plane...). Faktori peshues është 28%. Vlera e këtij indikatorit është fituar në bazë të perceptimit të nëpunësve përkatës shtetëror përgjegjës për veprimtaritë komunale në komunat. Duhet të përmendet që shpërndarja e variablave (notave) ka ndryshuar shumë, d.m.th. **në komunat ku pushteti lokal është nga partia e njëjtë politike me pushtetin kombëtar, tregon shkallë më të lartë të konsultimit nga ana e pushtetit qendror, ndërsa në komunat ku pushteti lokal është nga partia tjetër politike atëherë niveli i konsultimit është më i ulët.**

Sipas të dhënave të fituara, nota mesatare e këtij indikatorit është 2,80.

Indikator 1.3: Politika për borxhmarrje të komunave

Ky indikator tregon sa është ndikimi i politikave ekzistuese të komunave, me qëllim që mes tjerash të stimulohet zhvillimi i veprimtarive komunale si dhe shkalla e përgatitjes dhe dëshira e komunës për borxhmarrje. Vlera peshuese e këtij indikatorit është 45% dhe është më e madhe në këtë grup të indikatorëve, që tregon se politikat për borxhmarrje janë faktori më i rëndësishëm për dallim nga politikat tjera. Andaj, gjatë caktimit të vlerës së këtij indikatorit, përveç perceptimit të nëpunësve përkatës shtetërore, ishte hulumtuar edhe përgatitja e komunave për borxhmarrje. Në këtë drejtim, ishte notua nëse komuna planifikon të marrë borxh, a ka marrë vendim Këshilli, a është parashtruar kërkesë për pëlqim nga Ministria e Financave për realizimin e borxhmarrjes dhe në fund a ka realizuar ndonjë borxhmarrje.

Sipas rezultateve të fituara, nota mesatare për politikat ekzistuese për borxhmarrje të komunave në vitin 2011 është 2.50 që tregon për politikat joefikase që paraqesin problem për komunat për të bërë marrjen e borxhit. Kjo vlerë është pothuaj

identike me hulumtimin paraprak që kishte të bëjë me zhvillimin ekonomik lokal (2.55) që tregon pajtueshmëri në qëndrimin dhe vërtetim **se politikat aktuale për borxhmarrje janë një faktor kufizues për investime më të mëdha infrastrukture ne nivelin lokal, ndërsa nga ana tjetër komunat kanë nevojë më të madhe të hyrjes në borxh për të realizuar investime kapitale në nivelin lokal.** Prej gjitha komunave të analizuara, deri në vitin 2011 vetëm dy komuna kanë realizuar borxhmarrje, ndërsa njëra nuk planifikon aspak si dhe shtatë komuna tjera kanë marrë vendim nga Këshilli, por ende presin pëlqimin e Qeverisë për të marrë borxhin. Këto fakte shpijnë drejt tre konkluzioneve:

1. Komunat kanë nevojë për borxhmarrje për të realizuar investime infrastrukurore në nivelin lokal,
2. Ndikimi i pushtetit qendror në kuptim të së drejtës për borxhmarrje të komunave është e madhe, madje edhe vendimtare,
3. Numër i madh i komunave (60% në rastin tonë) presin përgjigje (pozitive ose negative) nga Qeveria që të mund të marrin borxh.

Fakti që një numër i madh i komunave e shohin borxhmarrjen si një mundësi për të përmirësuar shërbimet në nivelin lokal vërtetohet edhe nga ky hulumtim, nëse merret parasysh që prej 12 partner-komuna, deri në vitin 2009 vetëm një komunë ka parashtruar kërkesë për pëlqim nga ana e Ministrisë për Financa, në vitin 2010 është rritur në 5, ndërsa në vitin 2011, dy komuna vetëm më kanë realizuar borxhmarrjen dhe 6 tjera presin pëlqimin e Qeverisë.

2.3 Nën-indeksi i gjendjes financiare i komunave për ZEL

Faktori peshues i këtij nën-indeksi është 34%, ndërsa vlerat peshuese të secilit prej indikatorëve që formojnë këtë nën-indeks janë dhënë në tabelën më poshtë. siç mund të vërehet nga tabela, rëndësi më të madhe (peshë) ka indikator i 2.3 (50%) që ka të bëjë me mbështetjen financiare nga pushteti qendror për shërbimet komunale, ndërsa më të vogël ka indikator i për efektivitetin e realizimit të programeve për veprimtari komunale (12%).

Vlera e këtij nën-indeksi dhe indikatorët që e formojnë, bashkë me notat përkatëse mesatare nga gjitha komunat e realizuara për vitin 2011 janë dhënë në tabelën më poshtë. Nota mesatare e këtij nën-indeksi për vitin 2010 është 2.34 dhe është më e vogël për dallim nga nën-indeksitet tjera. Faktori më i rëndës peshues nga njëra anë dhe vlera më e vogël e nën-indeksit nga ana tjetër tregojnë për faktin që **gjendja financiare e komunave për veprimtaritë komunale është shumë kritike. Nëse merret parasysh fakti që shërbimet komunale shpesh jepen nga NPK, kjo bën me dije që edhe performanca e tyre financiare dhe nevoja është në nivel kritik.**

Përveç kësaj, plotësimi i direktivave të rrepta të BE-së në sektorin sigurisht që do të kërkojë investime më të mëdha kapitale të cilat NPK-të komunat nuk do të mund të arrijnë.

INDIKATOR / faktori peshues (%)	2011	
	Nota mesatare	NI 2
2.1. Efektiviteti i realizimit të programeve për veprimtari komunale – 12%	2,60	2,34
2.2. Investime kapitale në veprimtarinë komunale – 28%	2,10	
2.3. Mbështetja financiare nga pushteti qendror për shërbimet komunale – 50%	2,47	
2.4. Subvencionimi i punës së NPK-ve – 10%	2,00	

Indikator 2.1: Efektiviteti i realizimit të programeve për veprimtari komunale

Ky indikator jep një pasqyrë të shpenzimeve të planifikuara dhe ato të harxhuara për veprimtari komunale. Në këtë drejtim ishin krahasuar programet e planifikuara që janë zbatuar për veprimtari komunale në buxhetet origjinale dhe shpenzimet e vërteta sipas llogarive përfundimtare.

Në vitin 2010, partner komunat mesatarisht kanë planifikuar 3329 mkd/banor në programet për veprimtari komunale, ndërsa realizimi ka qenë 1855 mkd/banor (55%). Situata është identike edhe në 2011, kur ishin planifikuar 3326 mkd/banor ndërsa realizimi ka qenë 1859 mkd/banor (55). Sipas këtyre të dhënave, nota mesatare e indikatorit është 2,6.

Të dhënat tregojnë në faktin se komunat shpeshherë i vlerësojnë me lartë buxhetet e programeve për veprimtari komunale dhe mesatarisht arrijnë të realizojnë vetëm gjysmën e planit. Në këtë rast pyetjet që dalim në pah janë nëse komunat realisht i planifikojnë nevojat në sektorin komunal në nivel vjetor, ose planifikime i caktojnë me qëllim të tërheqin më tepër donacione dhe transferime, që vërehet se nuk janë arritur në vitin 2010 dhe 2011. Gjithashtu, komunat tregojnë rezultate të dobëta në lidhje me planifikimin afatgjatë të investimeve kapitale për veprimtari komunale. Do të thotë, **vetëm 30% të komunave kanë hartuar plane për planifikim shumëvjeçar të investimeve kapitale, plane që janë realisht të mbështetura me ndarje përkatëse buxhetore për zbatimin e tyre.** Duke marrë parasysh që planifikimi shumëvjeçar buxhetor mund të përdoret si mekanizëm për tërheqjen e financave plotësuese, pa dallim a është nga pushteti qendror ose institucione financiare ndërkombëtare, për çudi është fakti se një numër i vogël i komunave e zbatojnë në praktikë.

Indikator 2.2 Investime kapitale në veprimtarinë komunale

Indikatori jep vlerësim për investimet kapitale në komunat në krahasim me realizimin e plotë të programeve për veprimtari komunale. Faktori peshues i këtij indikator është 28%. Të dhënat tregojnë **që në vitin 2010, vetëm 277 mkd/banor kanë qenë të synuar për investime kapitale në sferën komunale që paraqet rreth 15% të buxhetit të plotë për programe komunale. Më e keqe është situata në vitin 2011 kur janë realizuar vetëm 233 mkd/banor ose 12.5% të buxhetit për programe komunale.**

Nëse këto të dhëna analizohen bashkë me indikatorin paraprak, padyshim mund të përfundohet se mosplotësimi i programeve për veprimtari komunale bëhet për shkak të pamundësisë së komunave të realizojnë investimet e planifikuara kapitale dhe që shpeshherë me programe komunale financohen vetëm shpenzimet aktuale në fushën komunale. Këto duhet të theksohet se komunat kanë në dispozicion pak të dhëna për realizimin e investimeve kapitale nga ana e NPK-ve, habit fakti se duke marrë parasysh që përgjegjësia për planifikim dhe zbatim të veprimtarive komunale mbetet sërish mbi komunat, jo në NPK që duhet të jenë vetëm “agjencia zbatuese” për zbatimin e politikave lokale dhe furnizimin e shërbimeve. Përfundimi do të ishte se **komunat dhe NPK-të në mënyrë të papërshtatshme e koordinojnë procesin e caktimit të prioriteteve zhvillimore të komunës, së paku në pjesën e veprimtarive komunale.**

Indikator 2.3. Mbështetja financiare nga pushteti qendror për shërbimet komunale

Ky indikator tregon çfarë pjese të mbështetjes financiare ka siguruar pushteti qendror për komunat që të stimulojë dhe zhvillojë shërbimet komunale. Faktori peshues është 50% dhe është më i madh për dallim nga vlerat peshuese të tre indikatorëve tjerë në këtë grup, që tregon menjëherë se edhe këto mjetet financiare që komunat i presin nga pushteti qendror janë parakusht kryesor për zhvillim dhe avancim të shërbimeve komunale. Vlerësimi ishte bërë në bazë të perceptimit të nëpunësve përkatëse shtetëror përgjegjës për veprimtari komunale, si dhe transferimeve nga pushteti qendror në pjesën e shërbimeve komunale dhe/ose projekte që janë kofinancuar bashkërisht mes pushtetit qendror dhe komunave.

Sipas të dhënave të fituara, nota mesatare e këtij indikator është 2.47. Këtu duhet të përmendet fakti se gjatë vitit 2011, Qeveria e Maqedonisë morri një kredi prej 50 milion euro nga Banka Investuese Evropiane për ndërtimin e sistemeve për ujësjellje dhe kanalizim dhe menjëherë, sipas kriterëve të caktuara paraprakisht dhe me vendi të Qeverisë, është ndarë në grante mes 84 komunave të vendit. Sërish, **komunat ende mendojnë se mbështetja financiare që marrin nga pushteti qendror për investime infrastrukturore në veprimtarinë komunale është shumë e nevojshme, por ende është minimale.** Kjo me siguri ndodh për shkak se veprimtaritë komunale

kërkojnë investime më të mëdha edhe në sferat tjera të fushës komunale për të cilat komuna është përgjegjëse, për shembull, transporti lokal publik, rrugë dhe rrugë lokale, ndriçimi publik, tregjet jeshile, etj.

Indikator 2.4. Subvencionimi i punës së NKP-ve

Ky indikator tregon nëse dhe në çfarë mase komuna e subvencionon punën e NKP të themeluara nga komuna për furnizim me shërbime të posaçme komunale. Faktori i peshës së tij është 10%, dhe është më i vogli në krahasim me vlerat e peshës së indikatorëve tjerë në këtë grup, që në mënyrë eksplicite tregojnë se për komunat, subvencionimi i punës së NKP është diçka e “natyrshme”. Të dhënat e fituara e vërtetojnë këtë, duke konsideruar faktin **gati 80% të komunave të analizuara e subvencionojnë punën e NKP**. Duke marr parasysh se investimet kapitale janë minimale, kjo e dhënë tregon se **në shumicën e rasteve subvencionimi la për qëllim të mbulon shpenzimet aktuale të punës**. Kjo mund të shpjegohet vetëm me ekzistimin e çmimeve joreale të shërbimeve ose me punën joefikase të NKP. Sa i përket kësaj, dhe në kontekst me qasjen në BE, duhet të kemi parasysh se direktivat e BE që i përkasin pjesës mbi ujësjellje dhe mbeturinat dukshëm kërkojnë që çmimi i shërbimeve në tërësi të mbulon shpenzimet për furnizim të shërbimeve, dhe veç kësaj, të siguron mjete për mirëmbajtje të investimeve. Mund të përfundohet se sektori komunal (si pjesë e „acqui-së“ për mjedis jetësor) do të paraqet një sfidë të madhe për komunat në procesin e qasjes së RM në BE. Duke marr parasysh kërkesat e rrepta që vendosen në këtë sektor, duhet që urgjentisht të fillohet me adaptimin e politikave lokale në drejtim të sigurimit të parakushteve për zbatimin e kërkesave të BE, kurse formimi i çmimeve të bazohet në shpenzimet reale të shërbimeve dhe rritjes së efikasitetit të NKP.

2.4 Nën-indeks për performancat e shërbimeve komunale në ZEL

Faktori i peshës të këtij nën-indeksi është 29%, kurse vlerat e peshës të secilit prej indikatorëve që e formojnë këtë nën-indeks janë dhënë në tabelën më poshtë, prej ku shihet se 3.2 dhe 3.3 kanë vlerën më të lartë të peshës, kurse kanë të bëjnë me efektivitetin e pagesës dhe mbulimit të popullsisë me ujësjellje dhe kanalizim. Rëndësi më të vogël ka indikatorin për vendosje organizative dhe formë (komuna, NKP, partneri privat) nëpërmjet cilës sigurohen shërbimet.

Vlera e këtij nën-indeksi që formohet me notat mesatare përkatëse nga të gjitha komunat e analizuar për vitin 2011 janë shfaqur në tabelë, kurse më poshtë është dhënë përshkrim në detaje të secilit prej indikatorëve.

INDIKATOR / faktori peshues (%)	2011	
	Nota mesat.	NI 3
3.1. Vendosja organizative dhe forma e sigurimit të shërbimeve komunale – 7%	4,10	3,15
3.2. Efektiviteti në pagesën – 24%	3,00	
3.3. Mbulim i popullatës me ujësjellje dhe kanalizim – 24%	3,50	
3.4. Mbulim i popullatës me shërbimin për nxjerrje dhe deponim të mbeturinave – 23%	3,30	
3.5. Shkalla e rrugëve lokale dhe rrugëve të asfaltuara/ mbuluara me pllaka – 12%	2,20	
3.6. Mbulim me ndriçim publik të rrugëve – 10%	2,80	

Indikator 3.1. Vendosja organizuese dhe forma e sigurimit të shërbimeve komunale

ky indikator e vërteton vendosjen organizative (strukturën) e administratës së komunës, që i organizon dhe siguron shërbimet komunale (vet komuna, NKP ose partner privat). Vlera e peshës së këtij indikator është 5% dhe sipas mendimit të nëpunësve përgjegjës shtetëror, tregojnë se forma e sigurimit të shërbimeve nuk ka rëndësi të posaçme. Në numrin më të madh të rasteve, komunat më të mëdha urbane kanë vendosur sektor të posaçëm kurse komunat më të vogla dhe ato rurale, përdorin departamente për veprimtari komunale në suaza të vendosjes organizuese dhe ka përmbushje e caktuar me numrin e duhur të zbatuesve.

Rezultatet tregojnë se **shërbimet komunale zakonisht sigurohen nga NK, por nuk është i vogël numri i shërbimeve komunale që sigurohen nga vet komunat. Sigurimi i shërbimeve nga partneri privat është forma më pak e përfaqësuar.** Në tabelën më poshtë është dhënë shqyrtim i përmblëdhur i formës nëpërmjet cilës sigurohen lloje të ndryshme të shërbimeve:

	Komuna	NKP	Partneri privat
Furnizimi me ujë të pijshëm	1	9	0
Largimi dhe spastrimi i ujërave të zeza	1	8	0
Transport publik i qytetit dhe rrethinës së qytetit	3	0	6

Përpunimi dhe deponimi i mbeturinave të forta komunale	0	8	0
Deponimi i mbeturinave industriale dhe materieve të dëmshme	0	6	0
Mirëmbajtja e pastërtisë së qytetit dhe lagjeve tjera	1	8	0
Mirëmbajtja dhe përdorimi i parqeve, gjelbërimit, park-pyjeve, ujërave dhe hapësirave rekreative	2	6	0
Mirëmbajtja e sinjalizimit të trafikut të rrugëve dhe objekteve tjera të infrastrukturës me rëndësi lokale	8	1	1
Mirëmbajtja e vareve, varrezave, krematorëve dhe ofrimi i shërbimeve për varrim	1	6	4
Mirëmbajtja ndriçimit publik	6	2	1
Mirëmbajtja dhe përdorimi i hapësirës publike për parkim	3	4	1
Kryerja e shërbimeve për pastrim të oxhaqeve	1		1
Mirëmbajtja e pajisjeve të komunës, (orëve të qytetit, çesmave, shatërvanëve dhe pajisjeve tjera komunale)	6	4	
Largimi dhe ruajtja e automjeteve të parkuara gabimisht, zhdukja e kafshëve endacake, stolisja e vendbanimeve, mirëmbajtja e njeve publike sanitare, pluhurim, dezinfektimi, deratizimi dhe të ngjashme	7	2	4
GJITHSEJ	40	64	18

Nota mesatare e këtij indikator është 4,1.

Indikator 3.2. Efektiviteti në pagesa

Ky indikator tregon sa dhënës të shërbimeve komunale arrijnë të paguajnë kërkesat e shërbimeve komunale të dorëzuara. Faktori i peshës së këtij indikator është 24% dhe së bashku me indikatorin për mbulim të popullatës me ujësjellje është më i madhi në këtë grup. Kjo tregon se **pagesa e shërbimeve perceptohet si kusht shumë i rëndësishëm për performancat e komunave në sigurimin e shërbimeve komunale.**

Sipas të dhënave të fituara, q[janë të ndryshme sa i përket llojit të shërbimeve komunale, dhe vërehen edhe variacione të rëndësishme prej komune në komunë. Kështu për shembull, në pjesën e ujësjelljes, kanalizimit dhe mbeturinave, pagesa lëviz prej 32% deri më 82% me vlerë mesatare prej 65%. Dukshëm më e mirë është pagesa për ndriçim publik me vlerë mesatare prej mbi 90%. Duke marr parasysh se pagesa për ndriçim kryhet nëpërmjet llogarive të EVN (kompani private për distribucion të energjisë elektrike), sugjeron edhe fakti se **ndërmarrjet publike komunale janë më pak efikase në pagesën e shërbimeve në krahasim me kompanitë private**. Nota mesatare e këtij indikatori është 3,0.

Indikatori 3.3. Mbulim i popullatës me ujësjellje dhe kanalizim

Ky indikator e vërteton mbulimin me ujësjellje dhe kanalizim të territorit të komunës. Sipas të dhënave të fituara, **mbulim më të madh kanë pjesët urbane, pjesët e komunës, kurse pjesët rurale janë pak të mbuluar me këto shërbime**. Vlera e peshës së këtij indikatori është 24%. Sipas të dhënave të fituara, vlera mesatare e këtij indikatori është 82% për ujësjellje dhe 61% për kanalizim kurse nota mesatare është 3,5.

Indikator 3.4. Mbulimi i popullatës me shërbimin largim dhe deponim i mbeturinave

Ky indikator e vërteton mbulimin me shërbimet për largimin dhe deponimin e mbeturinave komunale. Njëlloj sikur edhe me indikatorin e mëparshëm, **mbulim më të madh kanë pjesët urbane të komunave, kurse pjesët rurale janë më dobët të mbuluar me shërbimet**. Vlera e peshës së këtij indikatori është 23%. Sipas të dhënave të fituara, vlera mesatare e këtij indikatori është 70%, kurse nota mesatare është 3,3.

Indikator 3.5. Shkalla e asfaltimit (mbulimit me pllaka) të rrugëve lokale dhe rrugëve

Ky indikator vërteton se deri në çfarë shkalle janë asfaltuar (ose mbuluar me pllaka) rrugët lokale dhe rrugët që janë nën kompetenca të komunës. Ngjashëm si me indikatorët e mëparshëm, **më e madhe është përqindja e rrugëve të asfaltuara (mbuluara me pllaka) në rrugët urbane se sa ato rurale të komunave**. Vlera e peshës së këtij indikatori është 12%. Sipas të dhënave të fituara, prej gjithsej 1874 km gjatësi të rrugëve lokale dhe rrugëve, janë asfaltuar (mbuluar me pllaka) 820 km ose 44%. Përkatësisht, nota mesatare është 2,2.

Indikator 3.6. Mbulim me ndriçim publik të rrugëve

Ky indikator vërteton numrin e vendeve me poçe elektrike në nivel të komunave krahasuar me numrin e amvisërive në komunë. Rezultatet tregojnë se numri i vendeve të furnizuar me ndriçim me poçe për 100 amvisëri lëviz prej 18 deri 50 me

vlerë mesatare prej 31 vend të furnizuar me poç elektrik për ndriçim publik, për 100 amvisëri. Nota mesatare e këtij indikatorit është 2,3.

2.5 Nën-indeks për transparencë dhe përgjegjshmëri në ZEL

Faktori i peshës i këtij nën-indeksi është 15%, që do të thotë se sipas mendimeve të nëpunësve përgjegjës të shtetit, ky nën-indeks luan rol më të vogël në sigurimin e kompetencës. Ky nën-indeks matet me anë të dy indikatorëve, siç është shfaqur në tabelën më poshtë. Vlera e këtij nën-indeksi dhe i indikatorëve të cilët e formojnë atë, bashkë me notat përkatëse mesatare nga të gjitha komunat e analizuara në 2011, dhe përshkrimi i indikatorëve janë të dhënë më poshtë në tekst. **Duhet shënuar fakti që ky nën-indeks ka vlerë më të madhe nga të gjithë nën-indeksat tjerë, por prapë se prapë, duhet pasur parasysh që të dhënat e përdorura për llogaritje të këtij indeksi janë të marra nga komunat dhe kryesisht e reflektojnë përmbushjen e detyrave formale për transparencë dhe përgjegjshmëri.**

INDIKATORI / faktori peshues (%)	2011	
	Nota mesatare	NI 4
4.1. Transparencë dhe publicitet në aktivitetet komunale – 60%	4,09	4,13
4.2. Qasja ndaj informatave të karakterit publik – 40%	4,20	

Indikator 4.1. Transparencë dhe publicitet në aktivitet komunale

Ky indikator në vete i përmban: format dhe mënyrat në të cilat informatat për aktivitet komunale janë në diskutim për qytetarët, dhe përfshin komuna qytetarët në planifikimin dhe realizimin e programeve komunale dhe si e kryen këtë, mënyrat dhe format e komunikimit me qytetarët, a mund të marrin qytetarët kopje (në letër ose elektronike) të programit vjetor për aktivitete komunale dhe si mund të bëjnë këtë.

Sipas gjendjes që është prezantuar nga ana e komunave-partner, të gjitha komunat pa përjashtim, i shpallin publikisht programet vjetore për aktivitete komunale, a çdo qytetar i interesuar mund të marrë kopje (në letër ose elektronike) të programit. Format më të përdorura për njoftim të qytetarëve me programet vjetore janë: shpallje në mediet lokale të shtypura ose elektronike që e praktikojnë 90% e komunave, shpërndarje e fletushkave, afisheve ... (70%), tabela për shpallje në komunë (60%) dhe shpërndarje nëpër OJQ, bashkësi urbane ose lokale (30%).

Gjithashtu, të gjitha komunat-partner, pa përjashtim, i përfshijnë qytetarët në procesin e krijimit të programeve vjetore për aktivitete komunale. Format më të përfshira të pjesëmarrjes së qytetarëve janë mbledhje e qytetarëve në bashkësi urbane/lokale dhe komunikim direkt me të punësuarit në komunë, a më së paku është përfshirë forma e organizimit të diskutimeve publike për UZ dhe MZ në bashkëpunim me OJQ. Nota mesatare për komunat e analizuar më vitin 2011 është 4,09.


Indikator 4.2. Qasja ndaj informatave të karakterit publik

Ky indikator e cakton nivelin e qasjes të informatave të karakterit publik për komunën dhe caktohet në bazë të këtyre parametrave: numri i lutjeve të marra dhe të përgjigjur për qasje ndaj informatave të karakterit publik.

Sipas të dhënave, të gjitha komunat e analizuar bashkë kanë marrë gjithsej 56 lutje për qasje ndaj informatave të karakterit publik gjatë vitit 2011, e 18 nga këto lutje kanë të bëjnë me aktivitetet komunale. Për 48 lutje (16 nga sfera komunale) komunat i kanë dërguar përgjigjet në afatin e caktuar me ligj. Vetëm 2 ankesa janë dërguar tek Komisioni shtetëror për mbrojtje të së drejtës për qasje të lirë ndaj informatave të karakterit publik. Nota mesatare e këtij indikator është 4,2.

Përfundimi është që komunat kanë shumë pak lutje për qasje të informatave të karakterit publik dhe në 86% të rasteve, të njëjtit kanë marrë përgjigje në afatin e dhënë me ligj. Kjo tregon që qytetarët janë pak të njoftuar me instrumentet dhe mundësitë për hyrje tek informatat e karakterit publik.

Si që ishte përmendur më lart në tekstin, notat e larta në pjesën e transparencës dhe dhënies së llogarisë janë rezultat i përmbushjes së kërkesave ligjore si parakusht minimal për punë transparente dhe përgjegjshmëri të komunave. Sidoqoftë sipas kërkimeve në teren që janë bërë për projektin „Transparencë dhe decentralizim efikas“ perceptimi i qytetarëve për transparencën dhe përgjegjshmërinë të komunave është dhënë në tabelën më poshtë. Si që mund të vërehet notat mesatare për 2010 dhe 2011 janë 2,53 dhe 2,68 respektivisht, d.m.th. janë shumë më të ulëta. Ky fakt sugjeron që përmbushja formale e kërkesave ligjore nuk mjafton dhe që komunat duhet edhe thellësisht të tregojnë transparencë dhe përgjegjshmëri në punën e tyre, nëse duan të ndryshojnë perceptimit e qytetarëve dhe të vërtetojnë që me të vërtetë i respektojnë parimet e udhëheqjes së mirë.



	2010	2011
Transparencë dhe dhënie e rezultateve	2,53	2,68
Hyrje tek informatat e komunës	2,91	3,04
Hyrje tek informatat për shërbimet dhe aktivitete të komunës	2,73	2,87
Promovim i bashkëpunimit mes bashkësive të ndryshme etnike	2,70	2,80
Hyrje tek informatat për shërbimet dhe aktivitetet shtetërore	2,62	2,79
Hyrje tek informatat për punën e Këshillit të komunës	2,57	2,71
Pjesëmarrje e qytetarëve gjatë marrjes së vendimeve strategjike me rëndësi lokale	2,27	2,46
Njoftim i qytetarëve me harxhimin e buxhetit të komunës	2,20	2,39
Lufta kundër korrupsionit	2,19	2,37

3. Rekomandime

Prioriteti kryesor për stimulimin e jo vetëm zhvillimit, por edhe mbajtjen rrjedhëse të shërbimeve komunale në Republikën e Maqedonisë, si dhe përmbushje e kërkesave të rrepta të BE-së në sektorin e sigurimit të mjeteve të mjaftueshme financiare për komunat dhe ata që japin shërbime. Në këtë drejtim, mund të rekomandohen disa masa konkrete që merren direkt me aspektet financiare edhe atë:

- Të sigurohen kushte nga ana e pushtetit qendror për investime të rritura kapitale në sektorin komunal.
- Të lehtësohen dhe thjeshtëzohen kushtet për detyrimet financiare të komunave si mundësi për stimulim dhe zhvillim të sektorit komunal;
- Çmimet e shërbimeve komunale në tërësi t'i mbulojnë harxhimet për dorëzim të shërbimeve dhe të mënjanohet ndikimi i politikës ndaj formimit dhe përcaktimit të çmimeve;
- Të zmadhohet efikasiteti financiar dhe efikasiteti në punën e Ndërmarrjeve publike komunale;
- Të përmirësohet planifikimi i buxhetit për programet komunale dhe buxhetet zhvilluese nga ana e administratës komunale dhe doemos të përdoret planifikim shumë-vjetor i investimeve kapitale në veprimet komunale me përmbajtje përkatëse dhe konkrete nga buxheti.
- Të zvogëlohet subvencionimi i punës së NPK-ve. Subvencionet të përdoren vetëm për investime kapitale, e jo për harxhimet në vijim të NPK-ve.
- Të krijohen kushte për zmadhim të pagesës së shërbimeve të dërguara nga ana e NPK-ve deh parimisht të zbatohen dispozitat nga ligji në rast të mospagesës të shërbi meve komunale.

Rekomandimet tjera konkrete që nuk janë direkt të lidhura me aspektin financiar të aktiviteteve komunale dhe kanë të bëjnë me nevojën për mirëmbajtje dhe zhvillim të sektorit komunal, e me qëllim të sigurimit të shërbimeve kualitative komunale për qytetarët janë:

- Të zmadhohet shtrirja e dërgimit të shërbimeve komunale (ujësjellës dhe kanalizim, heqje dhe deponim i mbeturinave, ndriçimi publik i rrugëve, asfaltim i rrugëve lokale) në pjesët rurale të komunave.
- Të përforcohen kapacitetet e nëpunësve lokal të shtetit për implementim të Ligjit për ujëra dhe Ligjit për udhëheqje me mbeturina sipas parimeve.
- Administratat e komunës duhet seriozisht të përgatiten për realizim (planifikim, marrëveshje, udhëheqje dhe kontroll) të projekteve zhvilluese me përdorje të formës Administratat e komunave duhet seriozisht të përgatiten për realizim (planifikim, këshillim, drejtim dhe kontroll) të projekteve për zhvillim me përdorim të formës së partneritetit publik-privat në sektorin komunal, ku kapitali privat do të siguron përkrahjen financiare të nevojitur për realizimin e projekteve kapitale me interes publik komunal;
- Aktivitetet e ndërlidhura me punën transparente dhe përgjegjshmërinë e komunave duhet të jenë qenësore, jo formale. Përveç që pushteti (qendror dhe lokal) duhet të siguron qasje të lehtë, shpejtë dhe efikas ndaj të dhënave publike për qytetarët, ata duhet edhe të stimulojnë mësimin dhe njohjen e qytetarëve me të drejtat e tyre për qasje ndaj të dhënave.